

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Imazh Production & Distribution" shpk**

- Z. Klajd Spartak Papadhimitri, datëlindje 12.09.1985 qytetar shqiptar, me vendlindje në Tirane dhe banim në Rr. "Gjin Bua Shpata"; Nd. 7, H. 1, Ap. 4, Njësia Bashkiake NR. 5, Tirane.

Kam vendosur të nënshkruaj Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është **Imazh Production & Distribution Sh.p.k.**

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: rruga "M. Shyri", Pallati 55, Shk. 1, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri. 1001.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4 - Objekti i shoqërisë**

Shoqëria ka objekt veprimtarie si me poshtë:

- a- Shtëpi Filmike; Prodhimi i filmave artistike me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, prodhim i dokumentareve me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, apo i serive të dokumentareve. Bashkepunime me organizata të huaja për bashkeprodhime të ndryshme në fushën e filmit. Shpërndarja e filmave artistike me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, e dokumentareve me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, apo i serive të dokumentareve të prodhuara vetë. Bashkeprodhimi dhe shitja e telenovelave të prodhuara vetë. Prodhimi dhe bashkeprodhimi i filmave të animuar.
- b- Prodhimi, shitja dhe shpërndarja e spektakleve të ndryshëm kombëtare apo ndërkombëtare me vete ose në bashkeprodhim me televizione, radio apo edhe me mjete të tjera të medias elektronike.
- c- Organizimi i koncerteve apo spektakle të ndryshëm, me vete apo si bashkorganizator. Prodhimi dhe shitja e spoteve publicitare. Prodhimi dhe shitja e klipëve, videoklipëve të ndryshëm. Bashkeprodhime të ndryshme televizive dhe kinematografike.
- d- Hapja dhe menaxhimi i shkollave dhe i kurseve të ndryshëm të regjizures, aktrimit, kameres, fotografisë, fotomodeleve dhe modeleve. Hapja dhe menaxhimi i agjensive të ndryshme casting për aktore dhe fotomodele.



- e- Organizimi dhe menaxhimi i sfilatave te ndryshme te modes. Botime te ndryshme te perqendruara ne fushen e artit dhe te kinematografise.
  - f- Prodhimi dhe shitja e banerave, posterave, fletepalosjeve dhe billborde te ndryshme.
  - g- Organizimi dhe menaxhimi i veprimtarive te ndryshme lidhur me ngjarjet historike, kulturore dhe artistike dhe sportive brenda dhe jashte vendit.
  - h- Organizim dhe menaxhim i spektakleve teatrore.
- Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet, shtohet apo kufizohet ne baze të vendimit të Asamblesë se Ortakeve.

#### **Neni 5 - Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 leke i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.

#### **Neni 6 - Kontributet**

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:
  - Z. Klajd Spartak Papadhimitri, datëlindje 12.09.1985 qytetar shqiptar, me vendlindje në Tirane dhe banim në Rr. "Gjin Bua Shpata"; Nd. 7, H. 1, Ap. 4, Njësia Bashkiake NR. 5, Tirane, të cilit i përket një kuotë me vlerë nominale 100,000 leke, që i korrespondon 100% të kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 7 - Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

#### **Neni 8 - Administrimi**

- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:
  - Z. Klajd Spartak Papadhimitri, datëlindje 12.09.1985 qytetar shqiptar, me vendlindje në Tirane dhe banim në Rr. "Gjin Bua Shpata"; Nd. 7, H. 1, Ap. 4, Njësia Bashkiake NR. 5, Tirane, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë

qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

#### Neni 9- Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

#### Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

#### ORTAKËT

Z. Klajd Papadhimitri

*Klajd Papadhimitri*



Datë 13.12.2022